



**Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHE**

THIRRJE PËR OFERTË

Hartimi i Strategjisë për Marrëdhënie me Publikun

EC Ma Ndryshe fton ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet të dorëzojnë ofertat e tyre për hartimin e Strategjisë për Marrëdhënie me Publikun.

Qëllimi i përgjithshëm i Strategjisë është të zhvillojë parimet kryesore të komunikimit me publikun, të ndihmojë organizatën në përmirësim të komunikimit me publikun dhe të avancojë stafin e organizatës në komunikim dhe përdorim të kanaleve të komunikimit të jashtëm në mënyrë efektive për të përforcuar misionin tonë dhe për të arritur një audiencë më të gjerë. Strategjia e komunikimit duhet të harmonizohet edhe me qëllimet strategjike të organizatës.

Palët e interesuara për ofertim duhet të dërgojnë propozimin i cili duhet të përmbajë informata për metodologjinë e propozuar, afatin kohor dhe përbërjen e ekipit që do të angazhohet. Për hartimin e propozimit duhet shqyrtuar misioni, strategjia, puna dhe komunikimi i organizatës sonë ashtu që Strategjia të shërbejë për promovim më të avancuar të punës dhe rezultateve tona ndaj audiencës përkatëse.

Metodologjia e propozuar duhet të përmbajë informata mbi mënyrën e mbledhjes së informatave (pyetesor, diskutim në fokus grupe, etj.) si dhe fazat e tjera të punës si kanalet e propozuara të komunikimit, audiencia e synuar, përmbajtja dhe forma e komunikimit, etj., bashkë me informatat për afatin kohor.

Strategjia duhet të përmbajë së paku:

- ✓ Një analizë të plotë të misionit, vlerave, audiencës së synuar dhe kanaleve ekzistuese të komunikimit të organizatës sonë;
- ✓ Propozime për komunikim gjithëpërfshirës që përmbajnë qëllime të qarta dhe ofrojnë mesazhe kyçe të përshtatshme për audiencen synuara dhe kanalet e rekomanduara të komunikimit;
- ✓ Propozime për mjetet e komunikimit dhe monitorimin e përmbajtjes dhe përdorimit të tyre;
- ✓ Zhvillimin e mjeteve/mënyrës së matjes së efektivitetit të strategjisë së komunikimit dhe përpilimit të raporteve të rregullta;
- ✓ Planifikimin e sesioneve informuese/trajnimeve të përshtatura për anëtarët e stafit tonë për të përmirësuar aftësitë e tyre të komunikimit, duke u fokusuar në menaxhimin e mediave sociale, krijimin e përmbajtjes, teknikat e angazhimit dhe analitiken;

Dokumentacioni i aplikimit duhet të përmbajë edhe dokumentet në vijim:

Për ekspertet/grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;

Për kompanitë/konsorciumet dërgohen edhe Çertifikata e regjistrimit të biznesit, Çertifikata e numrit fiskal; Çertifikata e TVSH- së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së), CV-të e personave që do të angazhohen për realizimin e aktivitetit.

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren ~ Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 No.7, Prishtinë

www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 029-222-771 & 038-224-967

Pala ofertuese duhet të caktojë një person për komunikim me EC Ma Ndryshe. Ofertat duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike në info@ecmandryshe.org deri më 28/06/2023, ora 15:00 me shënim: “Strategjia për Marrëdhënie me Publikun”. Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm ekspertët / grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet fitues do të informohen/kontaktohen.